


SUSTAINABLE MUNICIPAL SERVICES (WASTE MANAGEMENT), KOSOVO



PROJEKT PILOT

**RIORGANIZMI DHE PLOTËSIMI I SHËRBIMIT TË MBLEDHJES SË MBETURINAVE
NË QENDRËN E QYTETIT DHE ZONËN CARRABREG**

KOMUNA DEÇAN

**PËRGATITUR NGA:
Merlina Beu- Mucaj
Besnik Krasniqi**

QERSHOR 2018

PËRMBAJTJA

Projekti Pilot	5
Draft Koncepti.....	5
1. Sfondi	5
2. Qëllimi i Projekti Pilot	5
3. Objektivat e Projektit Pilot	6
4. Qasja për hartimin dhe zbatimin e Projektit Pilot	7
5. Analiza e Situatës	8
6. Koncepti i Riorganizimit të Shërbimit në Zonën e Projektit Pilot.....	22
7. Kostot për Zbatimin e Riorganizimit të Shërbimit në Zonën e Projektit Pilot	31
8. Plani i Veprimit për Zbatimin e Riorganizimit të Shërbimit në Zonën e Projektit Pilot	32
9. Sistemi i Tregueseve për Matjen e Performancës	36
Aneks 1-Analizë teknike	37
Aneks 2- Disajni strukturor i PGM.....	37

Lista e figurave

Figura 1: Shtrirja e zonës së Projektit Pilot-Komuna e Decanit	8
Figura 2: Shtrirja e zonës së Projektit Pilot në qendër të qytetit	9
Figura 3: Shtrirja e zonës së Projektit Pilot në Carrabreg.....	9
Figura 4: Shpërndarja e popullsisë sipas dendësisë në qendrën e qytetit-plani zhvillimor urban.....	12
Figura 5 Mënyra e ofrimit të shërbimit për çdo zone sipas operimit aktual të kompanisë së grumbullimit Higjiena.....	13
Figura 6 Roza e përbërjes mesatare të mbeturinave (GIZ – Analiza e Mbturinave Komunale, Prishtinë 2009 – 2011).....	14
Figura 7: Shpërndarja aktuale e Konteinerëve dhe mbulimi me shërbim në zonën e qendrës së qytetit	16
Figura 8: Gjendja e pastrimit dhe e Konteinerëve në Deçan.....	16
Figura 9: Konteinerë plastik ose metalik 1.1 m3 dhe 240 l që do të përdoren në qendrën e qytetit.....	24
Figura 10: Demonstrim i dekorimit të konteinerëve të përbashkët rrugorë-modeli i përdorur në Gjakovë	25
Figura 11: Shpërndarja e pikave të grumbullimit në sistemin e mbledhjes së mbeturinave, zona qytetit Deçan	26

Lista e tabelave

Tabela.#1 Numri i popullsisë dhe amvisërive në komunën e Deçanit.....	10
Tabela 2: tabela përmbledhëse e popullsisë dhe numrit të amvisërive në zonën pilot.....	11
Tabela 3: Shpërndarja totale sipas entiteteve të subjekteve.....	11
Tabela 4: Shpërndarja e bizneseve sipas sektorëve në qendrën e qytetit.....	12
Tabela 5 Mbulimi me shërbim për popullatë.....	14
Tabela 6 Lista e infrastrukturës për shërbim poseduar prej kompanisë “Higjiena”	14
Tabela 7: Shpërndarja aktuale e Konteinerëve në zonën e projektit	15
Tabela 8: Numri i konteinerëve dhe shpërndarja e pikave të grumbullimit në zonën e qendrës së Deçan ...	25
Tabela 9: Numri total i konteinerëve sipas tipit dhe pikat e grumbullimit, qendra Deçan dhe Carrabreg	27
Tabela 10: Numri dhe shpërndarja e shportave rrugore	28
Tabela 11: Tabela përmbledhëse e konteinerëve sipas tipit për Projektin Pilot, Deçan	29
Tabela 12: Kosto e realizimit të projektit pilot	32
Tabela 13 Sasia totale e konteinerëve dhe shpërndarja e pikave të grumbullimit për mbledhjen e ndarë të mbeturinave në zonën pilot.....	49

MIRËNJOHJE

Ky dokument është punuar nga expertet e angazhuar ing. Merlina Beu Mucaj nga Green Art Center-Prishtina dhe eksperti Besnik Krasniqi nga BK-Consulting , në kuadër të projektit për “Shërbime të Qëndrueshme Komunale” i financuar nga GIZ.

Hartimi i këtij dokumenti është mbështetur nga Grupi Punues i Komunës Deçan në bashkëpunim të ngushtë me kryetarin e komunës së Deçanit z.Ramosaj si edhe z.Zenuni, Drejtori i DSHP pranë komunës së Deçanit.

Falenderim i veçantë në zhvillimin e këtij dokumenti adresohet për Znj. Drita Binaj, eksperte e GIZ-SMS, Kosovë për mbështetjen profesionale dhe për kontributin e drejtpërdrejtë në të gjithë këtë proces, si dhe drejtuesin e projektit Mr. Kai Hofmann për përkrahjen dhe inkurajimin për përmirësimin e shërbimit të mënaxhimit të mbeturinave në komunën e Decanit.

Projekti Pilot

RIORGANIZMI DHE PLOTËSIMI I SHËRBIMIT TË MBLEDHJES SË MBETURINAVE NË QENDRËN E QYTETIT DHE ZONËN CARRABREG

Koncept dokument

1. Sfondi

Qeveria e Kosovës ka si synim që të përmirësojë procesin e menaxhimit të mbetjeve komunale në mënyrë efektive dhe eficiente. Në këtë përpjekje, Qeveria e Kosovës kërkon që Komunitat të kenë gjithashtu në konsideratë faktin se duhet inkurajuar përmirësimi i shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, plotësimi i shërbimit duke synuar më tutje trajtimin e mbeturinave në proceset të tjera duke nxitur riciklimin, ripërdorimin dhe për rrjedhojë reduktimin e mbetjeve që depozitohen në vend-depozitimet (deponitë) e trajtimit përfundimtar të mbetjeve.

Në këtë përpjekje Komuna e Deçanit po ndihmohet nga GIZ në kuadër të projektit “Shërbime të Qëndrueshme Komunale”, në përputhje me dispozitat ligjore siç janë përcaktuar në ligjin 04/L-060/2012 “Për mbeturinat”, i ndryshuar dhe në Direktivën Kuadër për Mbetjet të Këshillit të Evropës 2008/98 EC.

Komuna ka krijuar një Grup Punues, si pjesë e përpjekjeve për të hartuar Planin e Menaxhimit të Mbeturinave i cili do të zbatohet në zonën qendër të qytetit të Deçanit.

GIZ ka siguruar mbështetje teknike për hartimin e këtij Projekti Pilot në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit që ka nënshkruar me Komunën e Deçanit.

2. Qëllimi i Projekti Pilot

Në kuadër të një Projekti Pilot, Komuna e Deçanit ka ndërmarrë një seri aktivitesh për të hartuar dhe zbatuar mbi bazën e një koncepti të ri, riorganizimin e shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbeturinave nga qendra e qytetit, si dhe në plotësimin me infrastrukturë të fshatit Carrabreg me qëllim përmirësimin e kushteve mjedisore, rritjen e efijencës së shërbimit dhe kontrollin e kostove të këtij shërbimi.

Komuna dëshiron të ndërtojë një sistem për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave komunale të suksesshëm duke u nisur nga qendra e qytetit, për ta shtrirë atë në drejtim të pjesës tjetër si dhe qendrave të tjera të banuara në periferinë e saj .

Krahas saj, si proces i ndërmarrë dhe drejt finalizimit nga aspekti ligjor,financiar dhe ekzekutiv prej komunës së Deçanit, Komuna është duke punuar në krijimin e kompanisë së saj komunale dhe plotësimin me asete për shtrirjen e plotë të shërbimit të mbledhjes së mbeturinave të gjeneruara në të gjithë territorin e komunës. Njëherësh,GIZ-SMS është duke e përkrahur në

ekspertizë teknike profesionale në hartimin e planit komunal për menaxhim të mbeturinave, plotësimin e të dhënave, hartimin e planit operativ, hartimin e planit për riorganizim të qendrës dhe plotësimin me infrastrukturë sipas nevojave të komunës.

Këto masa konkrete do të jenë të vlefshme edhe në kuadër të përpjekjeve të Komunës për hartimin dhe përditësimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave që parashihet të zhvillohet.

3. Objektivat e Projektit Pilot

Bazuar në analizën e gjendjes aktuale në organizimin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave dhe problematikave në komunën e Decanit, janë përcaktuar qartë veprimet konkrete dhe masat e menjëhershme, të cilat vijojnë sipas prioriteteve përkatëse:

- Riorganizimi i shërbimit në zonën qendër të qytetit dhe plotësimi i shërbimit në ekonomi familjare dhe biznese;
- Plotësimi i informatave/ Numri i saktë i amvisërive/ Zona ku kryhet shërbimi/ Përcaktimi i zonës për pilotim;
- Pilotimi i zonës për zgjerim (plotësim i shërbimeve)/ Caktimi i zonës për pilotim - Deçan, Carrabreg i Epërm dhe i ultë/ Marrja e të dhënave për zonën e pilotimit (nr. i amvisërive etj);
- Përgatitja e planit të ri operativ/ Përgatitja e organogramit/ Draftimi i Planit Operativ/ Implementimi i Planit të ri Operativ/ Plotësimi dhe monitorimi i Planit të ri Operativ;
- Përgatitja e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave/ Marrja e informatave dhe Draftimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave/ Rishikimi i rregullores për dhënien e lejes së ndërtimit: duke qenë si kriter edhe përcaktimi i lokacioneve për pikat e grumbullimit të mbeturinave (PGM-ve);
- Përdorimi i serverit për monitorim dhe raportim të kompanisë/ Licencimi i kompanisë Higjiena (përgatitja e dokumentacionit)/ Ofrimi i mbështetjes juridike për licencim/ Plotësimi i dokumenteve për licencim/ofrimi i software dhe përcaktimi i personave përgjegjës për software;
- Përgatitja logjistike për operim të kompanisë Higjiena.

Këto veprime të planifikuara do të kontribuojnë në:

- Riorganizimin e shpërndarjes dhe të sigurimit të kushteve të përshtatshme në numër të pikave të grumbullimit dhe kontejnerëve për ta sjellë shërbimin e mbledhjes së mbeturinave sa më afër banorëve dhe bizneseve në zonat e parapara;
- Harmonizimin funksional të sistemit të grumbullimit të mbeturinave në zonën e përcaktuar dhe shtrirje të shërbimit në të gjithë komunën në afate kohore.
- Të rrisë normën e pagesave të tarifës së shërbimit në përgjithësi dhe veçanërisht nga bizneset (operatorët ekonomik) që veprojnë në këtë zonë;
- Të ndërgjegjësojë dhe edukojë banorët dhe përfaqësuesit e bizneseve për mbajtjen pastër të mjedisit ku jetojnë dhe punojnë;

- Të forcojë inspektimin dhe zbatimin e ligjit dhe rregulloreve për menaxhimin e mbetjeve.

Komuna do të synojë ti adresojë këto objektiva në një afat të shkurtër kohor dhe do ti përfshijë rezultatet e këtij projekti në procesin e hartimit të Planit të Menaxhimit të Mbeturinave për të gjithë komunën.

4. Qasja për hartimin dhe zbatimin e Projektit Pilot

Pasi ka përcaktuar qëllimin dhe objektivat, për të realizuar këto objektiva, komuna me mbështetjen e GIZ-SMS, do të zhvillojë procese që do të përmbajnë:

- Riorganizimin e shpërndarjes dhe të sigurimin e kushteve të përshtatshme në numër të pikave të grumbullimit dhe konteinerëve për ta sjellë shërbimin e mbledhjes së mbeturinave sa më afër banorëve dhe bizneseve në zonën qendër të qytetit;
- Harmonizimin funksional të sistemit të grumbullimit të mbeturinave në zonën e përcaktuar dhe shtrirje të shërbimit në të gjithë komunën në afate kohore.
- Plotësimin e aspektit ligjor dhe operativ për kompaninë komunale që parashihet të krijohet;
- Rritjen e normës së pagesave të tarifave të shërbimit përgjithësisht dhe veçanërisht nga bizneset (operatorët ekonomik) që veprojnë në këtë zonë;
- Ndërgjegjësimin e komunitetit ;
- Forcimin e inspektimit dhe zbatimit të ligjit dhe rregulloreve për menaxhimin e mbetjeve.

Në kuadër të planit të riorganizimit të shërbimit në zonën pilot, komuna e Deçanit do të zhvillojë:

- Një analizë të qartë të gjendjes aktuale,
- Identifikimin dhe përcaktimin e rolit të akterëve të interesit dhe përfituesve të cilët përfshihen në këtë proces;
- Një koncept të qartë teknik dhe financiar që do të bëjë të mundur zbatimin e suksesshëm të Projektit dhe qëndrueshmërinë e rezultateve;
- Një plan të detajuar për vetëdijësimin dhe edukimin e qytetarëve;
- Një plan i detajuar të veprimtarive për të përmbushur këto objektiva.
- Një sistem treguesish të cilët do të shërbejnë për matjen e rezultateve.

Paraprakisht, përveç Punëtorive me Grupin Punues, konsulentët e GIZ me mbështetjen e grupit punues në Komunë kanë organizuar disa vizita në terren për të analizuar gjendjen aktuale të shpërndarjes së konteinerëve, shtrirjen dhe cilësinë e shërbimit, problemet që e shoqërojnë procesin si dhe gjendjen e infrastrukturës në këtë zonë.

Komuna me grupin punues dhe kompania komunale e grumbullimit të mbeturinave “Higjiena” udhëzohen që të organizojnë takime në një grup të fokusuar të përbërë nga qytetarë dhe përfaqësues të biznesit të cilët jetojnë dhe operojnë në zonën e mbuluar nga Projekti Pilot. Takimi në fokus grup do të synojë përvetësimin e opinionit qytetar në lidhje me objektivat e projektit.

5. Analiza e Situatës

Projekti Pilot shtrihet në zonën e qendrës së qytetit të Deçanit dhe kufizohet nga konturët siç tregohet në Figurën 1 në vijim.

Zona që do të mbulohet nga Projekti Pilot përfshin një sipërfaqe afërsisht të barabartë me rreth 1 km (99.18 ha).




Fig. #1: Shtrirja e zonës së Projektit Pilot-Komuna e Deçanit

Zona e qendrës është ndarë në 4 njësi, siç janë treguar në figurën që vijon të cilat komunikojnë me njëra tjetrën përmes rrugëve kryesore që lidhin qendrën e qytetit me të gjitha njësitet zonale.

Zona ka tipologji tipike urbane mikse me dendësi mesatare, ku përfshihen funksionet rezidenciale kryesisht me shtëpi të ulta, tregtare, institucionale dhe prezencë të ndërtimeve të larta kryesisht në qendrën e qytetit sipas zhvillimeve rezidenciale të kohëve të fundit.




Fig. #2: Shtrirja e zonës së Projektit Pilot në qendër të qytetit

Këto njësi në konfiguracionin e tyre të ndërtimit, ofrojnë tipologji kryesisht të njëjtë të përbërjes urbane dhe funksionale, duke qenë kryesisht rezidenciale dhe komerciale.



Fig. #3: Shtrirja e zonës së Projektit Pilot në Carrabreg

Në zonën e Projektit Pilot është shtuar edhe zona kadastrale e Carrabregut të Ulët dhe të Epërm e cila komunikon me zonën e qendrës nëpërmjet rrugës Dëshmorët e Kombit. Kjo zonë karakterizohet kryesisht si zonë me tipologji residenciale me prezencë të bizneseve të vogla. Në Deçan aplikohet sistemi i kombinuar i grumbullimit ku pjesa urbane e qytetit shërbehet me kontejnerë 1.1 m³ si dhe institucionet dhe bizneset e medha me kontratë (zbrazje të veqanta), ndërsa bizneset e vogla shërbehen me kontejnerë plastik 120l ose 1.1m/kub.

5.1 Të dhëna të përgjithshme

Zona e përzgjedhur e projektit zë një sipërfaqe prej rreth 99.18 ha. Zonat karakterizohen nga një popullsi e ulët dhe përzierje funksionale rezidenciale dhe komerciale. Duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga Komuna, vlerësohet se numri i popullsisë në zonën pilot është rreth 4002 banorë ¹ ndërsa në zonën Carrabreg i Epërm dhe i Ulët është total 3689 banorë. Duke u bazuar në të dhënat e poseduara prej komunës së Deçanit dhe kompanisë “Higjiëna”, të përfshira në shërbim të sistemit të menaxhimit të mbeturinave vlerësohet të ketë afër 634 amvisëri në zonën e Deçanit qendër ;si edhe në zonën Carrabreg i Epërm 216 amvisëri dhe Carrabreg i Ulët numri i amvisërive të përfshira në shërbim të sistemit të menaxhimit të mbeturinave është 318.

Nr	Zona Kadastrale	2017		2018		2022	
		Numri i Popullates	Numri i Amvisërive	Numri i Popullates	Numri i Amvisërive	Numri i Popullates	Numri i Amvisërive
1	Carrabreg i Eperm	1,446	205	1,522	216	1,610	206
2	Carrabreg i Ulët	2,059	302	2,167	318	2,293	303
3	Deçan	3,803	602	4,002	634	4,235	604

Tabela.#1 Numri i popullsisë dhe amvisërive në komunën e Deçanit

Në zonën qendër operojnë rreth 441 biznese kryesisht të vogla dhe të mesme ndërsa në Carrabreg rreth 73 biznese kryesisht të vogla.

Bizneset janë vendosur në dy rrugët kryesore të zones pilot, në rrugën “Luan Haradinaj” dhe “Dëshmorët e Kombit”. Megjithatë zyrtare të komunës shprehen se zona do të jetë në ndërtim për shkak të zgjerimit të rrugës kryesore në aksin kryesor në qytet si dhe gjatë përfundimit të ndërtesave të larta dhe rregullimit të hapësirave publike dhe mendohet që numri i bizneseve do të rritet.

¹ Dendësia e banimit sipas të dhënave të komunës së Deçanit

Në këtë zonë ndodhen edhe 11 institucione publike duke përfshirë: shkolla, objekte shtetërore etj.

	Vendbanimet	Amviseri	Komerciale	Institucione
1	Deçani	634	676	12
2	Carrabregu i Epërm	216	46	
3	Carrabrergu i Ulet	318	26	

Tab. #2: tabela përmbledhëse e popullsisë dhe numrit të amvisërive në zonën pilot

Tabela në vijim pasqyron shpërndarjen totale sipas entiteteve të subjekteve në fjalë.

Bazuar në të dhënat e poseduara prej Komunë nënkuptohet se mbeten jashtë shërbimit ky numër si më poshtë:

	Vendbanimet	Amviseri- jashtë shërbimit	Komerciale- jashtë shërbimit	Institucione-- jashtë shërbimit
1	Deçani	115	235	-
2	Carrabregu i Epërm	44	-	
3	Carrabrergu i Ulet	114	-	

Tab. #3: Shpërndarja totale sipas entiteteve të subjekteve

Përndryshe, në këtë zonë jetojnë rreth 634 amvisëri me një mesatare prej afërsisht 6.3 anëtarë për çdo familje .

Ne Carrabreg jeton praktikisht një popullsi prej rreth 534 amvisëri ose një popullsi prej rreth 3689 banorë.

Në terma të përgjithshëm popullsia që do të përfitojë nga ky projekt është rreth 7691 banorë ose rreth 1213 amvisëri.

Harta në vijim pasqyron dendësinë e popullsisë për çdo sektor në zonën e qendrës së qytetit. Sektorët me ngjyrë më të fortë përfaqësojnë ata sektorë më dendësi popullsie më të lartë.




Fig. # 4: Shpërndarja e popullsisë sipas dendësisë në qendrën e qytetit-plani zhvillimor urban

Bazuar në shpërndarjen e popullsisë dhe veprimtarive, nënkuptohet se qendra e qytetit mbetet si qendër e fokusit kryesor e cila grumbullon në vete të gjitha shërbimet dhe komunikon më secilën njësi urbane dhe rurale në mënyrë direkte duke mbyllur kështu nevojat dhe shërbimet për të gjithë sektorët. Nga informacioni i komunës, rezulton se në zonën e projektit operojnë rreth 749 biznese, por prej të dhënave të poseduara prej bisedimeve në sistem të shërbimit dhe aktive të shpërndara sipas sektorëve, tregohen në tabelën që vijon.

Sektorët	Nr. Në shërbim	Deçan	Carrabreg i Ulet dhe i Epërm
Bisnise te vogla	441	412	70
Bisnise të mesme	32	29	3
Bisnise të mëdha	-	-	-
Totali	514	441	73

Tab. #4: Shpërndarja e bizneseve sipas sektorëve ne qendrën e qytetit

Nga të gjithë këto biznese, bizneset e mesme trajtohen me kontratë të veçantë për mbledhjen e mbeturinave.

Gjithashtu në qendrën e qytetit, si dhe në Carrabreg funksionojnë shkolla dhe 11 institucione, të cilat që të gjitha trajtohen me kontrata të veçanta për mbledhjen e mbeturinave.

5.2 Mbulimi me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave

Mbledhja e mbeturinave ofrohet në të gjithë sipërfaqen e qendrës së qytetit, sipas ditëve të caktuara dhe të ndara me subjekte. Komuna aplikon një sistem të kombinuar i cili përbëhet nga:

1. Konteinerë mbitokësor, 1.1 m3,
2. Mbledhja derë më derë me qese ose me Konteinerë individuale

Frekuenca dhe orari i mbledhjes është i ndryshëm në zona të ndryshme të qytetit. Frekuenca kushtëzohet kryesisht nga tipi i Konteinerët, dhe paraqitet si me poshtë:

1. Zona e qytetit me Konteinerë sipërfaqësor 1.1m3 shërbehet një herë në ditë
2. Bizneset me Konteinerë sipërfaqësor 3 herë në javë
3. Zonat me Konteinerë sipërfaqësor 1.1
4. Amvisëritë në zonën Urbane 2 herë në Muaj me Konteinerë shtëpi me shtëpi e marrin shërbimin e mbledhjes se mbeturinave 1 herë ne 2 jave ne zonat e caktuar.




Fig # 5 Mënyra e ofrimit të shërbimit për çdo zone sipas operimit aktual të kompanisë së grumbullimit Higjiëna

Sipas studimit të bërë në terren, total i mbeturinave të gjeneruara në gjithë komunën e Deçanit është 26,4 ton në ditë dhe popullsia totale është 40.019 banorë të regjistruar në listën e subjekteve të përfshira në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, që do të thotë se gjenerimi për banor i mbeturinave është në masën 0.660 kg/banori/ditë, ndërkohë që vendbanimet e shërbyera janë 18 prej 37 vendbanimeve totale. Numri total i banorëve të regjistruar në listën e subjekteve të përfshira në sistemin e menaxhimit të mbeturinave është 22.507 banorë.

		Numri i Amviserive	Amviserite e sherbyera	Mbulimi me sherbim
Nr.	Komuna Decan	5887	1677	28.49%
1	Carrabreg i Epërm	216	161	75%
2	Carrabreg i Ulët	318	188	60%
3	Deçan	634	487	77%

Tab. #5 Mbulimi me shërbim për popullatë

Nr.	Përdorimi	Pika grumbullimi	Lloji i kontenierëve 1.1m3
1	Institucione	22	24
2	Amvisëri	2	4
3	Bisnese të vogla	7	22
4	Bisnese të mesme	1	2
	TOTALI	32	52

Tab. # 6 Lista e infrastrukturës për shërbim poseduar prej kompanisë “Higjiena”

- **Vlerësimi i sasisë së mbeturinave që gjenerohen në zonën pilot**

Deri tani nuk është kryer ndonjë hulumtim i thelluar në Komunën Deçan në lidhje me analizën e përbërjes së mbeturinave. Në vitin 2011 GIZ në Kosovë ka kryer një studim për përbërjen e fraksioneve të mbeturinave në nivel kombëtar.




Fig # 6 Roza e përbërjes mesatare të mbeturinave (GIZ – Analiza e Mbturinave Komunale, Prishtinë 2009 – 2011)

Sipas këtyre të dhënave, dhe duke supozuar se në zonën pilot jeton një popullsi prej rreth 6.392 banorë, vlerësohet së aty gjenerohet afërsisht rreth 0.6-0.7 kg/banor/ditë . Bazuar mbi këto të dhëna, do të rezultojë dhe do të pranojmë se në zonën pilot gjenerohen afërsisht **7691 banore x 0.6 kg/banor/ditë= 4614.6 kg mbetje/ditë.**

Bazuar në ndarjet e zonës qendër dhe Carrabreg, në zonën qendër gjenerohen afërsisht 2401.2 kg/mbetje/ditë.

Sipas tabelës së mëposhtme, për të ofruar shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, komuna posedon këtë rrjet aktual të shtrirjes së pikave të grumbullimit në zonën e pilotimit (pa përfshirë institucionet dhe shërbimet e vecanta).

Nr. Pikes	Vendndodhja	Nr. i Konteinereve
1	Sheshi Mentor tolaj	1 Konteinere
2	Rr.Luan Haradinaj	1 Konteinere
3	Mbrapa viva fresh store	3 Konteinere
4	Rruga Luan Haradinaj N.n.t Besimi	1 Konteinere
5	Parkingu etc/privat	5 Konteinere
6	Hyrje ne Qytet te Deçanit afer furra emira	1 Konteinere
7	Restorant Luana	1 Konteinere
8	Rruga te hotel Sëiss	2 Konteinere
9	Rruga Sali Ceku,Drejtimi te manastiri	3 Konteinere
10	Perball restorant Banana Split	2 Konteinere
TOTALI		20 Konteniere

Tab. # 7: Shpërndarja aktuale e Konteinerëve në zonën e projektit

Sipas tabelës më sipër, për të ofruar shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, komuna posedon këtë rrjet aktual të shtrirjes së pikave të grumbullimit në zonën e pilotimit (pa përfshirë institucionet dhe shërbimet e vecanta)

Harta në vijim pasqyron mbulimin me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave me sistemin e Konteinerëve në qendrën e qytetit, me rreze mbulimi prej 100 m linearë për çdo Konteinerë ose pikë grumbullimi.




Fig. # 7: Shpërndarja aktuale e Konteinerëve dhe mbulimi me shërbim në zonën e qendrës së qytetit.

Konteinerët sipërfaqësore janë vendosur në një rrjet prej 10 pikash grumbullimi (pa përfshirë bizneset me kontrata të vecanta dhe institucionet). Mesatarisht për çdo pikë grumbullimi ka min 1 Konteinerë, megjithëse ka pika vetëm me një Konteinerë dhe pika të tjera me më shumë se 2 Konteinerë.

Zonat e tjera të qendrës, të tipologjisë rezidenciale me shtëpi të ulta si dhe bizneset përgjatë rrugës kryesore në qendër, mbulohen kryesisht nëpërmjet mbledhjes së mbeturinave me konteiner sipërfaqësorë 120l-240l derë më derë.



Foto # 8: Gjendja e pastrimit dhe e Konteinerëve në Deçan

5.3 Problematika që shoqëron shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në zonën e qendrës

Gjatë analizës së gjendjes aktuale janë identifikuar disa probleme të cilat kanë nevojë të adresohen në kuadër të riorganizimit të shërbimit në këtë zonë, duke vijuar si më poshtë:

- Numër i pamjaftueshëm dhe shpërndarje e papërshtatshme e pikave të grumbullimit kushtëzojnë kërkesën për një numër më madh pikash grumbullimi dhe të Konteinerëve 1.1 m³;
- Vendosje të Konteinerëve të përbashkët në zona me lëvizje intensive të automjeteve dhe njerëzve që vështirëson qarkullimin dhe dëmton estetikisht pamjen dhe funksionet e zonës së qendrës së qytetit;
- Konteinerë të dëmtuar nga përdorimi dhe veçanërisht nga zjarri, për rrjedhojë të papërshtatshëm për shërbimin në zonën e qendrës së qytetit të cilët duhet të zëvendësohen me konteinerë të rinj;
- Në vende të caktuara, për shkak të terrenit, sipërfaqja e vendosjes së grupit të Konteinerëve është e papërshtatshme dhe vështirëson lëvizjen gjatë procesit të shkarkimit dhe ngarkimit në automjetet e bartjes së mbeturinave.
- Përzierja e mbetjeve që hidhen njëkohësisht nga bizneset dhe ekonomitë familjare në konteinerët e përbashkët duke shkaktuar ndotje, erë të keqe, mundësinë e afrimit të kafshëve, për rrjedhojë duke u kthyer në një potencial për përhapjen e infeksioneve të rrezikshme.
- Orari i parregullt i grumbullimit të aplikuar nga Operatori i shërbimit
- Përdorimi i konteinerëve publik prej bisniseve dhe amvisërive të cilët nuk paguajnë tarifën e shërbimit duke refuzuar në këtë mënyrë përmbushjen e detyrimeve dhe zbatimin e rregullores së komunës për menaxhimin e mbetjeve dhe rritur potencialin për krijimin e pikave të zeza pranë konteinerëve të vendosur.

Pamja institucionale

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Në fushën e administrimit të mbeturinave sipas Ligjit për Mbeturinat, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit

Hapësinorë ka këto kompetenca:

- Përcaktimi i politikave të përgjithshme për mbeturinat,
- Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë menaxhimin e mbeturinave dhe e sektorit për menaxhimin e mbeturinave,
- Hartimi i Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planit të Veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe zbatimin e tyre,

- Lëshimin e licencës për menaxhimin e mbeturinave dhe mbajtja e evidencës në regjistrin për licencë
- Dhënia e lejeve për import, eksport dhe kalim transit të mbeturinave;
- Zbatimi i marrëveshjeve në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar për menaxhimin e mbeturinave;

Me hyrje në fuqi të Ligjit të ri për Mbeturina (Nr.04/L-060), në bazë të nenit 82 dhe 83 të këtij ligji, MMPH-së i janë bartur edhe kompetencat që më parë kanë qenë në përgjegjësi të Zyrës Rregullatorë për Ujë dhe Kanalizim-ZRRUK.

Aqjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës - AMMK

AMMK si institucion ekzekutiv mjedisor kryen këto detyra dhe përgjegjësi në administrimin e mbeturinave:

- Mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për mbeturinat
- Krijimin e bazës së shënimeve dhe sistemit informativ për mbeturina,
- Hartimin e raporteve për gjendjen dhe menaxhimin e mbeturinave,
- Monitorimin e gjendjes së deponive sanitare, regjionale dhe lokale,
- Krijon bazën e shënimeve dhe sistemin informativ për administrimin e mbeturinave;
- Parashikon dhe paralajmëron mbi zhvillimet dhe efektet që ndërlidhen me mbeturinat.

Pushteti Lokal- Komunat

Komunat si institucione lokale në administrimin e mbeturinave kanë këto detyra dhe përgjegjësi:

- Krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre,
 - Hartimi i planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij;
 - Hartimin e raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës përkatëse dhe përkujdesja për sistemin e informimit të publikut,
 - Rregullimi i përgjegjësisë dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave,
- zbatimi i tyre organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;
- Përzgjedh personat e licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brenda territorit të tyre;
 - Cakton tarifat dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale
 - Evidentimi i vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimi i projekteve për sanimin e tyre me shënimet për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, lloji i ndotjes, sasia e

mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera me rëndësi për realizimin e projekteve;

Pamja institucionale Komuna Deçan

Akterët kryesorë në dhënien e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në Deçan janë Komuna dhe operatori N.K “Higjiena”.

Shërbimi i mbledhjes së mbeturinave, largimi i tyre në deponi realizohen nga operatori N.K “Higjiena” e cila është në proces të shndërrimit në ndërmarrje komunale, zotëruar tashmë edhe prej MZHE. Kjo ndërmarrje me statut të ri tashmë është duke procesuar me dokumentacionin e nevojshëm përcaktuar prej nivelit qëndror MZHE dhe MMPH për tu shndërruar në ndërmarrje komunale. Komuna e Deçanit përmes një kredie institucionale ka nisur procedurat për blerje të aseteve operacionale për ndërmarrjen e re komunale që është duke u funksionalizuar dhe është në proces të përmbushjes së dokumentacionit dhe obligimeve të saja për realizimin e këtyre veprimeve.

Komuna Deçan

Autoriteti i Komunës

Ligji për Vetqeverisjen Lokale e ka klasifikuar menaxhimin e mbeturinave si një nga “kompetencat e veta “ të këtij niveli qeverisës.

Ligji për “Mbeturinat” përcakton se grumbullimi, largimi i mbeturinave, organizohet nga komuna.

Udhëzimi Administrativ në zbatim të ligjit për “Mbeturinat” ka sqaruar se mirëmbajtja dhe pastrimi i sipërfaqeve ose hapësirave publike dhe private është pjesë e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.

Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave bëhet nga ndërmarrje profesionale të cilat autorizohen/krijohen ose kontraktohen nga komuna, me Licensë që aprovohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH) sipas ligjeve në fuqi.

Udhëzimi Administrativ që shoqëron zbatimin e ligjit “Për Mbeturinat” përcakton, ndërmjet të tjerave, se:

1. Komuna përcakton llojin e Konteinerëve;
2. Konteinerët për hedhje të mbeturinave duhet të vendosen në vende të dukshme dhe të përshtatshme ku nuk shkaktojnë pengesë apo rrezik për lëvizje të lirë të qytetarëve dhe qarkullim të mallrave;
3. Komuna ka detyrimin të organizojë sistemin për menaxhimin e mbeturinave ndërkohë që qytetarët, bizneset dhe institucionet kanë detyrimin e zbatimit të sistemit të vendosur nga komuna.

Inspektimi

Nëpërmjet strukturave të Inspektimit, Komuna ka autoritet të plotë për të inspektuar zbatimin e ligjit për “Mbeturinat” si dhe ligjeve e akteve nënligjore për mbrojtjen e mjedisit. Nën këtë autoritet, Komuna mund të vendosë dhe zbatojë penaltet në moszbatim të ligjit për “Mbeturinat”, si dhe mbi gjobat e detyrueshme sipas Udhëzimit mbi gjobat e detyrueshme Administrative (04/2009).

Tarifimi

Aktualisht Komuna operon me sistemin tarifor i cili është vendosur më herët nga Zyra e Rregullatorit të Ujrave dhe Mbeturinae. Por, që pas hyrjes në fuqi të ligjit “Për mbeturinat” Komuna gjithashtu vendos tarifat e shërbimit si dhe mekanizmin e mbledhjes së të ardhurave. Aktualisht inkasimi i të ardhurave nga tarifa e shërbimit të mbeturinae kryhet nga Kompania “Higjiena”.

Kompania komunale e Mbeturinae “Higjiena”

Kompania komunale e Mbeturinae “Higjiena” është krijuar dhe do të operojë sipas dispozitave të ligjit për “Ndërmarrjet komunale” në republikën e Kosovës. Format i marrëdhënieve të komunës me operatorin (kompaninë) vendoset nga komuna. Brenda kuadrit ligjor aktual, marrëdhëniet e komunës me kompaninë rregullohen sipas dispozitave të ligjit “Për mbeturinat” dhe ligjit “Për ndërmarrjet publike”. Bazuar në Udhëzimi administrativ mmph nr.09/2014 licenca për menaxhimin e mbeturinae, Neni 4 : Cdo person që ushtron veprimtarin për menaxhimin e mbeturinae duke përfshirë edhe mbikëqyrjes sipas nenit 55. Te ligjit për mbeturina, duhet të bëjë kërkesë në ministrin, për tu pajisur me licencë për menaxhimin e mbeturinae .

Kompanisë për proces të licensimit do ti duhet të plotësojë dokumentacionin e mëposhtëm:

Kërkesa e plotësuar – sipas Shtojcës 1 të këtij udhëzimi administrativ

2. Lejen mjedisore komunale për objektet dhe veprimtaritë për menaxhimin e mbeturinae për të cilat nuk kanë obligim për pëlqim mjedisor.
3. Dokumentet që vërtetojnë pronësinë e objektit dhe pajisjes: fletën poseduese, kopjen e planit ndersa për objektet dhe pajisjet nën qera apo shfrytëzim edhe kontratën mes palëve.
4. Pëlqimin mjedisor ose Lejen mjedisore për objektet dhe veprimtaritë për menaxhimin e mbeturinae për të cilat është i nevojshëm pëlqimi mjedisor duke përjashtuar veprimtarin për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinae.
5. Çertifikatën e regjistrimit të biznesit
6. Çertifikatën e numrit fiskal
7. Vërtetimin tatimor për pagesën e tatimeve nga Administrata Tatimore e Kosovës
8. Planin për menaxhimin e mbeturinae, sipas dispozitave të nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina.
9. Dëshmi për kualifikimin të nivelit universitar të drejtuesit teknik – diploma –kopje e vërtetuar, kontrata e punës kopje e vërtetuar dhe CV e tij.
10. Lista e të punësuarve, bashkangjitur me kontratat e punës (kopje) të lidhur ndërmjet operatorit dhe punëtorëve.
11. Lista e pajisjeve (makinae, mjeteve të punës) dhe automjeteve për veprimtarinë e caktuar për menaxhimin e mbeturinae, (për automjetet kopjen e librezës).
12. Fletëpagesa për taksën administrative në vlerë 10 (dhjetë) euro, në xhirollogari të Ministrisë për parashtrim të kërkesës për Licencën për menaxhim të mbeturinae.

13. Personi me rastin e aplikimit për licencimin e operatorit për menaxhim të deponive të mbeturinave, kërkesës për licencë, përveç shënimeve dhe dokumenteve të kërkuara nga pika 1-11 në këtë tabelë, duhet t'ia bashkëngjis edhe Planin për menaxhimin e deponisë së mbeturinave (duke përfshi përshkrimin për monitorimin, mbylljen dhe rikultivimin) nga personat e licencuar sipas nenit 7, të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2012 për menaxhimin e deponive të mbeturinave.

14. Personi që aplikon për Licencën për menaxhim të mbeturinave, përveç kërkesave të paragrafit 1 të nenit 7, të këtij udhëzimi administrativ duhet t'i plotësojë edhe kushtet teknike sipas Shtojcës 7, të këtij udhëzimi administrativ. Kërkesat për kushtet teknike, vlerësohen nga Komisioni i Ministris pasi të dal ne teren

Ndërkohë,që kushtet teknike që duhet të posedojë do të jenë:

- 1.Të posedojë sipërfaqe së paku 500 m², e cila duhet të jetë e rrethuar me rrethojë të përshtatshme.
2. Të ketë zyrë/hapësirë të veçantë për punët administrative.
3. Të ketë staf të mjaftueshëm dhe të trajnuar për punët që i kryen.
4. Pajisjet dhe makineritë për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave të jenë përshtatshme dhe adekuate për llojin e mbeturinave.
5. Për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave komunale së paku 2 (dy) kamion: -Një për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave nga kontejneret me vëllim deri 1,1 m³ ; -Një për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave nga kontejneret me vëllim 3-10 m³.
6. Të posedojë kapacitet të mjaftueshëm të pajisjeve për zonën që e mbulon duke përfshirë edhe kontejnerët.
7. Të ketë kontenierë për ndarje të mbeturinave në lloje për atë zonë ku bëhet ndarja;
8. Në hyrje të qendrës të ketë tabelën informuese me shënimet: emrin e personit, adresen nr. telefonit, kohën e pranimit të mbeturinave.
9. Të mirëmbajë pastërtinë në hapësirat e objektit.
10. Të posedojë rrjetat apo mbulesat për të mbuluar mbeturinat gjatë bartjes me makineri/kamion të hapur.
11. Dera e hyrjes në objekt të jetë konstruktuar që pa pengesë të bëhet qarkullimi i automjeteve të punës.
12. Të ketë hapësira të veçanta të objektit për të vendosur pajisjet dhe makineritë për mbledhje të mbeturinave si dhe veglat e punës.
13. Mbeturinat e mbledhura ti dërgojë në vendin e caktuar për grumbullim, trajtim, ruatje ose deponim.

Forma e operimit të Kompanisë do të behët në marrëveshje me Komunën e Deçanit sipas kërkesave të parashtruara prej Komunës. Mementalisht, kompania operon me buxhet të pavarur. Aktiviteti primar i saj është grumbullimi dhe largimi i mbeturinave. Njëkohësisht kompania shërben dhe si agent për faturimin dhe mbledhjen e tarifës së shërbimit, të ardhurat të cilat shërbejnë për të mbuluar koston e këtij shërbimi.

Marrëdhëniet e kompanisë me klientët realizohen kryesisht nëpërmjet faturës për pagesën e tarifës dhe në raste të veçanta edhe me kontrata shërbimi, kryesisht për disa biznese dhe institucionet në përgjithësi. Faturimi bëhet një herë në muaj.

Shërbime të tjera sekondare si mirëmbajtje e rrugëve, gjelbërimi etj., realizohen nga operatorë privatë të cilët kontraktohen nga Komuna sipas dispozitave të ligjit për prokurim publik.

6. Koncepti i Riorganizimit dhe plotësimit të Shërbimit në Zonën e Projektit Pilot (Qendra e Qytetit Deçan)

Koncepti i riorganizimit të shërbimit të grumbullimit dhe largimit të mbeturinave në zonën e qendrës së qytetit të Deçanit ka për qëllim që të propozojë vendosjen e një sistemi funksional, i cili do të sigurojë komoditetin dhe kushte higjienike e mjedisore optimale për qytetarët, si dhe për veprimtaritë ekonomike dhe institucionet që operojnë në këtë zonë.

Riorganizimi i shërbimit në zonën e mbuluar nga Projekti Pilot do të zhvillohet duke u bazuar në:

1. Ligjet në Republikën e Kosovës;
2. Përcaktimi i zonës së shërbimit;
3. Roli i aktorëve të interesit dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre;
4. Përcaktimi i kushteve teknike dhe standardit të shërbimit (programi I mbledhjes së mbledhjes së mbeturinave, përfshirë:
 - a. Rrymat e ndarjes së mbeturinave;
 - b. Tipi dhe numri i Konteinerëve;
 - c. Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve;
 - d. Orari i grumbullimit;
 - e. Pronësia e Konteinerëve;
5. Roli i aktorëve të interesit.
6. Lehtësimi i vetëdijesimit dhe edukimit.
7. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve.

Koncepti do të përputhet me tipologjinë urbane të zonës duke marrë në konsideratë se qendra e qytetit përveçse një zonë rezidenciale, ofron kushte për kryerjen e funksioneve ekonomike, institucionale dhe rekreative.

6.1 Kushtet ligjore të konceptit

Koncepti i propozuar do të bazohet në përcaktimet ligjore që rrjedhin nga ligji “Për Mbeturinat”, si dhe “Udhëzimit Administrativ për Administrimin e Mbeturinave nga Sipërfaqet Publike” të cilët detyrojnë prodhuesit e mbeturinave (përfshirë amvisëritë, bizneset dhe institucionet) që të bartin të gjitha shpenzimet për menaxhimin e mbeturinave dhe të ndajnë mbeturinat në burim sipas rregullave dhe akteve për shërbimet komunale të caktuara nga komuna.

Po sipas këtyre akteve ligjore dhe rregullores së komunës, amvisëritë dhe të gjithë prodhuesit e tjerë të mbeturinave detyrohen ti hedhin mbeturinat në vendet dhe sipas sistemit të caktuar nga komuna.

Këto përcaktime ligjore i referohen mbeturinave komunale përfshirë ato të amvisërive, komerciale dhe të ngjashme me to, si dhe mbeturinave të vëllimshme dhe ato ndërtimore (deri në masën nën 0.1 m³).

Ligji si dhe Udhëzuesi Administrativ përcaktojnë si ndalesa dhe kufizime (kundërvajtje ose shkelje ligjore), hedhjen e mbeturinave, nga subjektet që i prodhojnë ato, në vende të papërcaktuara dhe të paautorizuara nga komuna.

Koncepti do të zhvillohet pavarësisht sistemit të tarifimit, normës (përqindjes) së mbledhjes (inkasimit të të hyrave) dhe mekanizmave që përdoren aktualisht për mbledhje e tyre.

6.2 Kushtet teknike dhe standardet e shërbimit për konceptin e riorganizimit të grumbullimit të mbeturinave në qendrën e qytetit Deçan

Mbledhja e mbeturinave në zonën e Projektit Pilot do të mbështetet në sistemin dhe kriteret teknike si vijon:

1. Përdorimi i unifikuar i Konteinerëve 1.1 m³ të përbashkët për të gjitha amvisëritë në objekte kolektive dhe bizneset tregtare për grumbullimin e përzierë të mbeturinave.
2. Përdorimi i Konteinerëve 1.1 m³ të veçantë për mbledhjen e mbeturinave për institucionet dhe shkollat me kontratë të veçantë.
3. Përdorimi i Konteinerëve 1.1 m³ të veçantë për bizneset me kontratë të veçantë.
4. Përdorimi i Konteinerëve plastik 240 L për grumbullimin e mbeturinave të përziera, nga një grup i kufizuar biznesesh të cilët gjenerojnë mbeturina të veçanta që shkaktojnë erë të keqe, si mbeturina mishi etj.
5. Frekuenca e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për të gjithë kategoritë e klientëve do të jetë min 1 herë në ditë/zona qendër;
6. Konteinerët 1.1 m³ do të vendosen në vende të sheshta, të asfaltuara ose të shtruara më rënie të lirë 30 shkallë gradë, për të lehtësuar lëvizjen, ose përndryshe në platforma të parapërgatitura për rastet kur vend-vendosja nuk i plotëson kushtet e kërkuara. Vendet ose platformat ku do të vendosen Konteinerët 1.1 m³ do të kenë hapësirë të mjaftueshme për të pranuar të paktën edhe dy Konteinerë shtesë për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në të ardhmen. Konteinerët do të rrethohen nga tre anë aty ku paraqitet e nevojshme sipas aspektit estetik, deri në lartësinë e konteinerët më materiale të lehta dekorative për të evituar kontaktin e drejtpërdrejtë të banorëve/bizneseve dhe siguruar estetikën e nevojshme për qendrën e qytetit.



Fig. # 9: Konteinerë plastik ose metalik 1.1 m³ dhe 240 l qe do të përdoren në qendrën e qytetit

6.3 Kriteret për llogaritjen e numrit të Konteinerëve

Sistemi i grumbullimit të mbeturinave në zonën e Projektit Pilot do të bazohet në funksionalitetin e nën zonave të qytetit.

Llogaritja e numrit të Konteinerëve të përbashkët me kapacitet 1.1 m³ dhe pikave të grumbullimit do të bazohet mbi kriteret si më poshtë:

1. Distanca ndërmjet pikave të grumbullimit do të jetë 100 metra nga njëra-tjetra me rreze 50 m për çdo pikë. Në këtë mënyrë shpërndarja e pikave të grumbullimit të mbeturinave do të japë një mbulim maksimal dhe të njëtrajtshëm.
2. Peshë optimale e një kontejneri 1.1 m³ të mbushur plot me mbetje mikse (të përzierë) vlerësohet rreth 250 kg;
3. Faktori i mbushjes së konteinerit 1.1 m³ do të llogaritet 70% e peshës së mbushur plot, për rrjedhojë pasha efektive në një konteiner plot do të llogaritet rreth 160 kg/m³.
4. Llogaritja e numrit të konteinerëve plastikë 240 L do të bazohet në numrin e bizneseve tregtare të cilat gjenerojnë mbeturina të veçanta.
5. Frekuenca e grumbullimit max 2 herë në ditë

Sistemi i ri i vendosjes së pikave të grumbullimit me konteinerë 1.1 m³ do të ndërtohet duke marrë në konsideratë:

- a. Të përjashtojë vendosjen e pikave të grumbullimit me konteinerë 1.1 m³ nga rrugët me lëvizshmëri intensive, shëtitoreve dhe hapësirat rekreative;
- b. Të konsiderojë me përparësi distancat ndërmjet grupeve të konteinerëve si më sipër;
- c. Të garantojë një itinerar të vazhdueshëm të lëvizjes së automjetit për grumbullimin e mbetjeve;
- d. Të sigurojë që në varësi të terrenit konteinerët të kufizohen nga kontakti i drejtpërdrejtë me bizneset apo amvisëritë që të mos ndikojë pamjen dhe të lehtësojë lëvizjen e tyre gjatë zbrazjes në automjetet e grumbullimit;
- e. Të përcaktohet saktësisht numri i pikave të grumbullimit me qëllim paraqesin nevojë për intervenim në kushte të funksionimit si edhe dekorim dhe lloji i dekorimit.



Fig. # 10: Demonstrim i dekorimit të konteinerëve të përbashkët rrugorë-modeli i përdorur në Gjakovë

6.4 Konfigurimi i rrjetit, rrugët/itinerari për grumbullimin e mbeturinave

Mbi bazën e kritereve më sipër, dhe në varësi të tipit të konteinerëve rrjeti i shpërndarjes së pikave të grumbullimit të mbetjeve në zonën e qendrës së qytetit të Deçanit përbëhet nga 10 pika të shpërndara siç janë përmbledhur në tabelën që vijon dhe në ratën treguese, Fig. # 8 më poshtë:

Qendra	Nr.	Nr i konteinerëve	Lloji i konteinerëve	Kushte teknike infrastrukturore
Lokacioni	1	4	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	2	3	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	3	3	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	4	2	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	5	4	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	6	6	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	7	5	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	8	3	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	9	3	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
	10	3	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
Institucione	11 Institucione + kompleksi Memorial	24	1.1m3	Jo mirë/Aktuale
Gjithsej		60		

Tab. # 8: Numri i konteinerëve dhe shpërndarja e pikave të grumbullimit në zonën e qendrës së Deçanit

Harta në vijim tregon shpërndarjen gjeografike të pikave të grumbullimit dhe zonën e mbulimit për çdo pikë.




Fig. #11: Shpërndarja e pikave të grumbullimit në sistemin e mbledhjes së mbeturinave, zona qytetit Deçan .

I gjithë rrjeti prej 22 pikash do të përbëhet nga një total prej 60 Konteinerësh, prej të cilëve 24 do të vendosen në hapësirat e brendshme të institucioneve publike me kapacitet 1.1m3 (duke përfshirë 3 kontenierë për kompleksin memorial).

Ndërkohë që në zonat me shërbim derë më derë me karakter residencial, do të bëhet plotësim-zgjerim shërbimi për mbledhjen e mbeturinave të amvisërisë përmes kontenierëve 240l.

Numri total i nevojshëm për infrastrukturë do të jetë;

- Konteinerë 1.1m3 60 metal dhe 40 plastikë
- Konteinerë 120 l 380 copë
- Konteinerë 240 l 380 copë

Tabela në vijim do të pasqyrojë në mënyrë përmbledhëse pikat e grumbullimit dhe numrin total të kontenierëve sipas tipit që propozohet të vendosen në rrjetin e qendrës së qytetit dhe lagjen 2 Korriku.

Zona e qytetit	Lloji i konteinereve	Nr. i konteinereve	Nr. i pikave te grumbullimit
Qendra e qytetit dhe institucione	1.1 m3	60	10 + 11 institucione+kompleksi Memorial
Carrabreg i ulet	240l	318	
Carrabreg i eperm	240l	216	
Decan qendër	240l	634	
Bisnise vogla/mesme	240l	514	
Totali	240l	1682	

Totali	1.1 m3	60	
---------------	---------------	-----------	--

Tab. # 9: Numri total i konteinereve sipas tipit dhe pikat e grumbullimit, qendra Deçan dhe Carrabreg

Sistemi me konteinerë të përbashkët i ofron banorëve një mundësi për të hedhur mbeturinat e tyre në mënyrë të përqëndruar, ku operatori mund të vazhdojë të bëjë grumbullimin e mbeturinave nga këto zona në mënyrë të rregullt me efikasitet kohor dhe ekonomik.

Duke u bazuar në këtë rrejt të shpërndarjes konstatohet se përmes 10 pikave të grumbullimit në qytet më kapacitet të numrit të konteinereve 36 copë/a.a m3, do të mundemi të përllogarisim që kjo infrastrukturë ka kapacitet për :

$36 \text{ konteinerë} \times 160 \text{ kg/konteiner} = 5760 \text{ kg/mbeturina në ditë nëse mbushja e tyre arrin } 70\% \text{ të totalit për konteniër.}$

Kjo do të thotë që nëse zona qendër gjeneron rreth 2401.2 kg mbeturina në ditë pa llogaritur bisniset, mundemi të konkludojmë që maksimalisht ky rrjet pikash përmbush kushtet për deponimin 24 orësh të mbeturinave ditorë që gjenerohen në këtë zonë.

6.5 Mbledhja mbeturinave derë më derë nga amvisëritë

Mbledhja e mbeturinave derë më derë sipas përbërjes urbane do të vijojë kryesisht në amvisëri dhe biznese të vogla. Grumbullimi parashihet të bëhet për zbrazjen e konteinereve 240l me një mjet transporti që sigurohet nga operatori. Frekuenca e operimit do të përcaktohet sipas kriterëve të grumbullimit. Me planin e ri operativ planifikohet të bëhet ndarja e qytetit në zonën urbane të shërbimit dhe zonën e Carrabregut, ku secila zonë në shërbimin e amvisërisë do të ketë të përcaktuar dhe njoftuar tek qyteti ditën e grumbullimit sipas frekuencës një herë në javë. Shërbimi derë më derë tek bizneset parashihet të bëhet një herë në ditë në zonën qendër sipas intervalit kohor që përcaktohet nga kompania. Shërbimi tek bizneset në zonën Carrabreg i Eperm dhe i Ulët do të bëhet duke u bazuar në sasinë e gjenerimit të mbeturinave sipas llojit të biznesit duke marrë në konsideratë min 3 herë në javë.

6.6 Pikat e grumbullimit të mbeturinave nga bizneset e mëdha me kontratë të veçantë

Aktualisht **numërohen ? biznese** të cilat shërbejnë me kontratë të veçantë, dhe rrjedhimisht me konteinerë të veçantë. Këto biznese do të vazhdojnë të shërbejnë në të njëjtën mënyrë, rrjedhimisht me konteinerë 1.1 m3, numri i të cilëve do të përcaktohet nga sasia e mbeturinave që gjenerojnë.

Në këtë koncept presupozohet se paraprakisht këto biznese janë të pajisur me konteinerë, megjithatë do të parashihet shtesë e numrit të konteinereve për këtë kategori klientësh.

6.7 Grumbullimi i mbeturinave nga bizneset tregtare/prodhuese që gjenerojnë mbeturina të veçanta

Komuna ka identifikuar të gjitha ato biznese tregtare apo prodhuese të cilat operojnë në zonën e qendrës dhe Carrabreg, të cilat gjenerojnë mbeturina të veçanta që shkaktojnë erë të keqe apo përcjellin rrezik tek qytetarët.

Në varësi të sasisë së mbeturinave që gjenerojnë këto biznese do të pajisen me konteinerë të veçantë, potencialisht të tipit plastik me kapacitet 240 L për të evituar hedhjen e mbeturinave që ato gjenerojnë në konteinerët e përbashkët.

Në këtë koncept presupozohet se këto biznese nuk janë të pajisur me konteinerë, për rrjedhojë do të parashikohet shtesë e numrit të konteinerëve për këtë kategori klientësh pasi të jetë bërë identifikimi dhe përcaktimi i saktë i numrit të këtyre klientëve. Kështu komuna ka propozuar të vendosen konteinerë 240 l për biznese që ndodhen në zonë.

6.8 Rrjeti i shportave rrugore në rrugët kryesore

Cilësia e pastrimit të rrugëve kryesore në qytet përbën një problem. Një nga shkaqet që sjellin këtë situatë është edhe mungesa e shportave rrugore ku kalimtarët mund të hedhin mbeturinat e rastit. Për këtë arsye ne *propozojnë që komuna të marrë në konsideratë vendosjen e shportave rrugore fillimisht në rrugët:*

1. Rr. "Luan Haradinaj "
2. Rr. "Deshmorët e Kombit"
3. Rr. "Sali Ceku"

Si dhe në hapësirat publike që shfrytëzohen prej qytetarëve.

Shportat rrugore propozohet të vendosen në të dy anët e rrugëve, në intervalin çdo 50 m nga njëra – tjetra. Numri total i shportave rrugore vlerësohet të jetë njësi të shpërndara bazuar në distancat rrugore të akseve të propozuara si në tabelën në vijim:

Është llogaritur që të vendosen shportat në dy krahët e rrugës në çdo 50m distancë.

Rruga	Gjatësia (në të dy krahët) m	Nr. shportave
"Luan Haradinaj "	1000 m	40
"Deshmorët e Kombit"	1160 m	44
"Sali Ceku"	260 m	10
Totali	2420 m	94

Tab. # 10: Numri dhe shpërndarja e shportave rrugore

6.9 Përmbledhëse e konteinerëve në funksion të zbatimit të planit të riorganizimit të shërbimit

Tabela në vijim pasqyron në mënyrë të përmbledhur tipin dhe numrin respektiv të konteinerëve në funksion të riorganizimit të shërbimit të mbledhjes së mbeturinave në qendrën e qytetit në kuadër të Projektit Pilot të Propozuar.

Tipi i konteinerit	Ekzistues	Të rinj	Totali
1.1 m3 të përbashkët	20	36 zëvendësim dhe shtese PGM	36
1.1 m3 shkolla - institucione		20	24
240 L biznese			1682
Shporta rrugore	0	94	

Tab. # 11: Tabela përmbledhëse e konteinerëve sipas tipit për Projektin Pilot, Deçan

Konteinerët ekzistues pas vlerësimit të gjendjes fizike të tyre do të zëvendësohen me konteinerë të rinj dhe ekzistuesit do të përdoren në destinacion tjetër sipas nevojave të kompanisë.

6.10 Frekuenca dhe orari i grumbullimit të mbetjeve

Shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve nga zona e qendrës së qytetit do të kryhet çdo ditë të javës, d.m.th. 7 ditë në javë.

Orari i shërbimit të grumbullimit dhe largimit në këtë zonë të qytetit do të jetë 07:00-15:00 ose mbas orës 20:00 në mbrëmje.

6.11 Pronësia e konteinerëve

Konteinerët, përfshi këtu konteinerët e përbashkët, si dhe konteinerët individuale për shërbimet private tregtare dhe institucionale janë pronë e komunës. Konteinerët e përbashkët 1.1 m3, 240 - 120 l do ti jepen me marrëveshje përdorimi Kompanisë/operatorit që bën grumbullimin dhe largimin e mbeturinave. Konteinerët 1.1 m3 në përdorim të bizneseve të mëdha do ti jepen në përdorim me marrëveshje këtyre njësive. Konteinerët 240 L do ti jepen në përdorim me marrëveshje shërbimeve tregtare private. Përdoruesit do të kenë përgjegjësinë për të mirëmbajtur dhe siguruar funksionalitetin e këtyre mjeteve për gjatë gjithë kohës së përdorimit sa ç'është jetëgjatësia e përdorimit të këtyre mjeteve në përputhje me standardet e kontabilitetit që aplikohen në Republikën e Kosovës.

Nëse këto mjete bëhen të papërdorshëm brenda afatit të jetëgjatësisë së përdorimit, përdoruesit do ti zëvendësojnë ato me mjete të tjera të të njëjtit standard, me burimet e tyre financiare.

6.12 Roli i aktorëve të interesit në zbatimin e projektit

Realizimi i projektit pilot në qendrën e qytetit dhe lagjen Carrabreg do të kushtëzohet nga përcaktimi i saktë dhe ushtrimi i rolit të çdo aktori të përfshirë në këtë proces. Secili nga aktorët që do të përfshihen, do të ushtrojë minimalisht përgjegjësitë si më poshtë vijojnë:

1. Roli i Komunës:

- a. Komuna do të emërojë një nëpunës / zyrtar përgjegjës për projektin pilot.
- b. Komuna do të vendosë standardet e shërbimit të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në sa më poshtë:
 - a. Mënyrën e mbledhjes së mbeturinave mikse,
 - b. Mënyrën e mbledhjes së mbeturinave në shkolla dhe institucione,
 - c. Frekuencën dhe orarin e shërbimit;
 - d. Në varësi të interesit të komunës, standardi mund të përmbajë ditën dhe vendet e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme dhe atyre të ndërtimit, për të cilat komuna do të caktojë një vend të veçantë.
- e. Rolin dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve që përfshihen në këtë proces;
- f. Burimet e financimit për zbatimin e projektit.
- c. Publikimi i rregullave të reja në faqen e internetit të komunës, komunikim në media si dhe prodhimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve dhe veprimtarive vetëdijësuese për të gjithë klientët e zonës së qendrës së qytetit.
- d. Mbështet me vetëdijësimin dhe edukimin e qytetarëve, bizneseve, nxënësve dhe nëpunësve në institucione; Komuna do ti shfrytëzojë të gjitha këto kanale të shkëmbimit të informacionit për të synuar një kapjen e një hapësire sa më të madhe të qytetarëve dhe publikut në përgjithësi.

2. Roli i Kompanisë “Higjiena ”

- a. Kompania do të emërojë një nëpunës / zyrtar përgjegjës për projektin pilot.
- b. Kompania siguron shpërndarjen dhe servisimin e konteinerëve të përbashkët, institucionet dhe bizneset;
- c. Kompania do të vazhdojë me kostot, pajisjet dhe fuqinë punëtorë të grumbullojë dhe largojë mbeturinat nga qendra e qytetit dhe zona Carabreg sipas sistemit të ri dhe në kombinim me sistemin ekzistues.
- d. Komuna dhe Kompania kontrollojnë zbatimin e rregullave dhe standardit të shërbimit

6.13 Monitorimi dhe kontrolli i cilësisë së shërbimit

Monitorimi dhe kontrolli i cilësisë së shërbimit do të jetë subjekt i përbashkët i Kompanisë dhe Komunës.

Kompania do të inspektojë çdo ditë gjendjen e shërbimit dhe të pajisjeve në përdorim dhe do të raportojë në komunë për të gjitha rastet të cilat përbejnë një devijim nga normat dhe rregullat e vendosura nga komuna për ushtrimin e këtij shërbimi.

Një devijim do të quhet çdo rast i cili vjen në kundërshtim me përcaktimet e ligjit 04/L-060 Për Mbeturinat, dhe veçanërisht kur:

- (i) evidentohen konteinerë të dëmtuar,
- (ii) evidentohet zhvendosje e konteinerëve nga pikat e aprovuara të grumbullimit,
- (iii) evidentohet hedhja e mbeturinave nga prodhuesit përfshirë amvisëritë, bizneset dhe institucionet, në vende të papërcaktuara dhe të pakontrolluara ose jashtë sistemit të përcaktuar nga komuna.
- (iv) evidentohet refuzim i përmbushjes së kushteve të kontratës ose të marrëveshjes me klientët,
- (v) evidentohet mos pagesë e tarifës së shërbimit, etj.

Aktiviteti i Kompanisë si dhe sjellja e klientëve do të monitorohen gjithashtu nga Inspektorati Komunal. Inspektori dhe drejtuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit do të asistojnë Kompaninë në ushtrimin e autoritetit ligjor sa herë që do të kërkohet nga kjo e fundit.

Inspektori Komunal do të hartojë një raport mujor të cilin nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike do t’ju paraqesë për shqyrtim Kryetarit të Komunës. Raporti përveç sa kërkohet në ligjin “Për Mbeturinat”, do të përmbajë edhe masat dhe sanksionet e propozuara për klientët apo Kompaninë kur provohen devijime të përcaktuara si më sipër dhe përgjithësisht sipas dispozitave të Neneve 70 e në vijim të ligjit 04/L-060, “Për Mbeturinat”. Të dhënat e raportit do të publikohen në faqen e internetit të komunës dhe ne media.

7. Kostot për Zbatimin e Riorganizimit të Shërbimit në Zonën e Projektit Pilot

Kostot për realizimin e projektit pilot për riorganizimin e shërbimit në qendrën e qytetit dhe në zonën Carrabreg, do të shoqërohet me zërat e kostos si më poshtë. Shpërndarja e kostove përfshin kostot që do të mbulohen kryesisht nga Komuna dhe nga organizata partnere si GIZ e ndonjë tjetër donatorë.

Në kolonën # 5 të tabelës në vijim pasqyrohet shpërndarja e financimit të kostove kapitale dhe për vetëdijesim sipas burimeve të financimit².

1. Kosto kapitale				Burimi i financimit
1	2	3	4	5
Zërat e kostos	Njësi	Kosto/njësi	Shuma	
Blerje konteinerë të rinj 1.1 m3	60	330 €	19 800€	GIZ

² Shpërndarja e kostove sipas burimeve të financimit duhet të saktësohet nga Komuna dhe GIZ

1. Kosto kapitale				Burimi i financimit
Konteinerë 240 L	1682	28 €	47 096€	GIZ
Shporta rrugore (50 x 70)	94	50€	4 700€	Komuna
Ndërtimi i strukturave dekorative	5	1500 €	7 500€	Komuna /GIZ
Totali kosto kapitale			79 096 €	
Totali kosto donatori			74 396	GIZ

Tabela # 12: Kosto e realizimit të projektit pilot

Buxheti përfundimtar do të reflektojë cmimet e blerjes së konteinerëve dhe kontratën përfundimtare për vetëdijësimin dhe ndërgjegjësimin nga GIZ e cila paraqet kosto shtesë.

8. Plani i Veprimit për Zbatimin e Riorganizimit të Shërbimit në Zonën e Projektit Pilot

Synimi për Rezultatet e Propozuara për Vitin 2018 - 2019

Nëpërmjet këtij Plani Veprimi për Riorganizimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave në qendrën e qytetit dhe në zonën Carrabreg, Komuna e Deçanit do të tentojë arrijtjen e objektivave dhe të rezultateve ashtu siç janë prezantuar në vijim.

Zbatimi i Planit të Veprimeve do të shtrihet në intervalin kohor qershor 2018 dhe do të përfundojë në Shtator 2018. Plani do të rishikohet çdo tre muaj nga Grupi punues për të matur performancën dhe për të bërë adoptimet e nevojshme në kuadër të ndryshimeve që mund të shfaqen gjatë zbatimit.

Ne mënyrë të përmblodhur Komuna e Deçanit do të arrijë gjatë vitit 2018 – 2019 të:

1. Të sigurojë numrin e mjaftueshëm dhe rishpërndarje e papërshtatshme e pikave të grumbullimit në zonën e qendrës së qytetit dhe në zonën Carrabreg;
2. Të plotësojë integrojë konteinerët mbi tokësorë 1.1 m3 në një sistem të harmonizuar të përbashkët për amvisëritë dhe entitetet e tjera
3. Të plotësojë, selektojë dhe zëvendësojë të gjithë konteinerët të dëmtuar nga përdorimi dhe veçanërisht nga zjarri me konteinerë të rinj;
4. Të rregullojë platformat e vendosjes dhe dekorojë pikat e grumbullimit të konteinerëve në mënyrë të përshtatshme për të evituar problemet me klientët por dhe ti kthejë ato të përshtatshme nga ana estetike.
5. Të plotësojë dhe sigurojë ndarjen e mbeturinave të veçanta që gjenerohen nga disa biznese të veçanta në qendër të qytetit duke siguruar konteinerët të përshtatshëm për këto biznese

6. Të plotësojë ndryshojë orarin e grumbullimit të mbeturinave nga kompania Higjiena në përshtatje më aktivitetin më të ulët shoqëror, tregtar dhe institucional në zonën e qendrës së qytetit.
7. Të rrisë përqindjen e pagesës së bizneseve, amvisërive dhe institucioneve që operojnë në zonën e qendrës dhe Carrabreg.
8. Të rrisë vetëdijesimin e qytetarëve për t'ju përgjigjur standardit të ri si dhe kërkesës për pagesën e tarifës së shërbimit.

Synimi për Produktin e Propozuar për Vitet 2018 - 2019

Duke shtuar burimet dhe mjetet për dhënien e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave për të arritur një standard dhe shtrirje më të lartë si dhe kënaqshmërisë së qytetarëve për shërbimin e pastrimit, Komuna Deçanit do të rrisë treguesit e produktit në nivelet si më poshtë:

1. Vendosjen e 46 konteinerëve 1.1 m3 në zonën e qendrës së qytetit gjatë periudhës së zbatimit të planit;
2. Blerjen dhe vendosjen e konteinerëve 1.1 m3 dhe 120l në zonën e Carrabregut gjatë periudhës së zbatimit të planit;
3. Blerjen dhe shpërndarjen me kontratë të konteinerëve 120L, 240L dhe 1.1m3 për bizneset që gjenerojnë mbeturina me natyrë të veçantë.

Nëpërmjet këtyre burimeve/input-eve shtese Komuna do të rrisë nivelin e produktit në:

1. Do të sigurojë një shërbim cilësor për rreth 7308 banorë si dhe të gjithë institucionet në zonën e qendrës dhe zonën Carrabreg .
2. Do të sigurojë shërbim të veçantë për biznese në zonën e qendrës.
3. Do të sigurojë largimin e rreth afershishtë 5 ton/ditë mbeturina nga zona e qendrës dhe zona Carrabreg.
4. Do të sigurojë rritjen e pagesave / inkasimin prej amvisërive
5. Do të sigurojë rritjen e pagesave / inkasimin prej bizneseve

Veprimet prioritare, Afatet dhe Përgjegjësitë.

Për të udhëhequr zbatimin e këtij Plani, Komuna ka caktuar si persona përgjegjës, nëpunësit si më poshtë vijojnë:

Grupi Punues-Komuna Deçan

Plani i Veprimit për riorganizimin e Shërbimit të Grumbullimit të Mbeturinave do të realizohet nëpërmjet hapave dhe ndarjes së përgjegjësisë si më poshtë:

Nr.	CFARE	KUR	KUSH
	Veprime paraprake		
i	Përfundim / finalizimi i dokumentit të Projektit Pilot dhe përcaktimi i burimeve të financimit	Qershor 2018	DSHPI/GIZ-GAC/BK CONSULTING
ii	Shpallja publike e Projektit Pilot dhe e Planit të Punës	Qershor 2018	Komuna e Deqanit
iii	Konference /deklarate për shtyp nga Komuna	Korrik 2018	Komuna e Deqanit
iv	Përfshirja si e Planit ne kuvend komunal	Qershor 2018	Komuna e Deqanit
	Veprimet per zbatimin e planit		
1	Përgatitja e specifikimeve teknike për konteinerët 1.1 m3, prokurimi ³ dhe furnizimi	Perfunduar	GIZ
2	Përgatitja e specifikimeve teknike për konteinerët 240 L, prokurimi ⁴ dhe furnizimi	Perfunduar	GIZ
3	Përgatitja e specifikimeve teknike dhe skicave ⁵ i dekorit për pikat e grumbullimit	Korrik 2018	DSHPI / Urbanistika/
4	Marrëveshja me Organizatën Jo-qeveritare për fushatën vetëdijësuese	Korrik 2018	DMMP, GIZ, OJQ
5	Përgatitja dhe prodhimi i materialeve për fushatën e vetëdijesimit	Gusht 2018	DMMP, GIZ, OJQ
6	Ndërtimi I platformave për pikat e grumbullimit ku do të vendosen konteinerët	Gusht 2018	DMMP, GIZ, OJQ
7	Mbledhje e Grupit Punues për të analizuar ecurinë e zbatimit të projektit dhe rishikimin e planit të veprimeve	Shtator 2018	DSHP
8	Debate me qytetarë nga Komuna	Korrik 2018	Kryetari / DSHP
9	Fillimi I fushatës së vetëdijesimit, , fletët informuese	Gusht 2018	DSHP/GIZ
10	Identifikimi dhe lidhja e marrëveshjeve me bizneset qe do te furnizohen me konteinerë 240 L	Korrik 2018	DSHP,HIGJHIENA,Inspeksioni, Organet e taksave

³ Specifikimet teknike dhe prokurimi jane kryer nga GIZ

⁴ Specifikimet teknike dhe prokurimi jane kryer nga GIZ

⁵ Kërkohej sqarim per procedurat e prokurimit

Nr.	CFARE	KUR	KUSH
11	Ndërtimi i dekorit të pikave te grumbullimit	Gusht 2018	DSHP
12	Furnizimi dhe vendosja e konteinerëve	Gusht 2018	DSHP/HIGJIENA/GIZ
13	Furnizimi i bizneseve me konteinerë 240 L	Gusht 2018	DSHP/HIGJIENA/GIZ
14	Instalimi i shportave rrugore	2018	DSHP
15	Mbledhje e Grupit Punues për të analizuar ecurinë e zbatimit të projektit dhe rishikimin e planit të veprimeve	Gusht 2018	DSHP
14	Konference për shtyp nga Komuna	Korrik 2018	Kryetari / DMMP
15	Identifikimi i amvisërive, bizneseve dhe institucioneve që nuk paguajnë tarifen	Gusht 2018	Grupi Punues. DSHP/HIGJIENA
16	Forcimi i punës për mbledhjen e tarifës sipas skemës së aprovuar	Tetor 2018	Inspeksioni, Autoritetet e taksave dhe tatimeve
17	Fillimi i operimit të sistemit të ri të grumbullimit të mbeturinave	Gusht 2018	HIGJIENA,DSHP
18	Mbledhje e Grupit Punues për të analizuar ecurinë e zbatimit të projektit dhe rishikimin e planit të veprimeve	Shtator 2018	DSHP
19	Konference për shtyp nga Komuna	Tetor 2018	Kryetari / DSHP
20	Analiza përfundimtare e ushtrimit të Projektit Pilot	Tetor 2018	DSHP
21	Shpallja e rezultateve të Projektit Pilot	Nentor 2018	Kryetari / DSHP
22	Hartimi i një rasti studimor dhe rekomandime për shtrirjen e projektit	Nentor 2018	Grupi punues, GIZ
23	Seminar për shpërndarjen e përvojës nga Projekti Pilot	Nentor 2018	Grupi i Punës

9. Sistemi i Treguesve për Matjen e Performancës

Përcaktimi i treguesve për matje të performancës së aktiviteteve të lartëpërmendura do të bazohet në :

Plotësimin e Shërbimit i Grumbullimit të Mbeturinave, përmes:

1. Numri i konteinerëve 1.1 m3 të përbashkët për mbledhjen e mbeturinave
2. Numri i konteinerëve 240 L për bizneset dhe amvisëri
3. -Nr. I pikave të grumbullimit me platformë dhe dekor
4. Nr. I shportave rrugore të instaluar

Produkti bazuar në plotësimin e shërbimit do të targetojë :

1. Nr. popullsisë që përfitojnë shërbimin nga sistemi me konteinerë të përbashkët
2. Nr. amvisërive që përfitojnë shërbimin nga sistemi me konteinerë të përbashkët
3. Nr. i bizneseve që përfitojnë shërbim me marrëveshje të veçantë
4. Sasinë në Ton/ditë mbeturina të grumbulluara nëpërmjet sistemit me konteinerë të përbashkët
5. Nr. i vendeve të grumbullimit të mbeturinave që kanë një platformë dhe janë dekoruar
6. Nr. I bizneseve që paguajnë tarifën e shërbimit
7. Nr. I familjeve që paguajnë tarifën e shërbimit

Rezultati i procesit (outcome) do të matet përmes:


1. -% e popullsisë që marrin shërbim nga sistemi i konteinerëve të përbashkët
2. -% e amvisërive që marrin shërbim nga sistemi i konteinerëve të përbashkët
3. Nr. i rrugëve që mbulohen me rrjet shportash rrugore
4. Rritja e normës së mbledhjes së tarifës së shërbimit të familjeve (në %)
5. Rritja e normës së mbledhjes së shërbimit të bizneseve (në %)

Aneks 1


ANALIZE TEKNIKE E LOKACIONEVE




Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 1 N:42.539684 E:20.285805
Nr i konteinerëve	1
Gjendja fizike e konteinerëve	Jo e mire
Gjendja fizike e lokacioneve	Jo e mire
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	Po
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Të vendosen 4
Qasja për operim	Prej rruges kryesore
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	Mundesi zhvendosje ne krahun tjetër te rruges




Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 2 N:42.53989 E:20.284967
Nr i konteinerëve	Ska- Pike e re
Gjendja fizike e konteinerëve	/
Gjendja fizike e lokacioneve	E mirLokacion i pershtatshem per ti sherbyer 3 ndertesave
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	/
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 3 Kontejner
Qasja për operim	Ne brendesi te oborrit te banesave
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	Ska nevoje



Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 3- pike e re N:42.539463 E:20.286406
Nr i konteinerëve	Ska- Pike e re
Gjendja fizike e konteinerëve	/
Gjendja fizike e lokacioneve	Kushte per lokacion
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	/
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 3 Kontejner
Qasja për operim	Prej parkingut
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	Betonim



Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 4 – pike e re N:42.53918 E:20.28663
Nr i konteinerëve	2x 120l
Gjendja fizike e konteinerëve	/
Gjendja fizike e lokacioneve	/
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	Po
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 2 Kontejner
Qasja për operim	Nga hyrja prapa komunes
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	Ska nevojë




Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 5 –pike e re prane komunes N:42.540115 E:20.287783
Nr i konteinerëve	Ska- Pike e re
Gjendja fizike e konteinerëve	/
Gjendja fizike e lokacioneve	E vetmja mundësi per lokacion
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	/
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 4 kontejner
Qasja për operim	Nga rruga kryesore ne kthim prej drejtimit te manastirit
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	Nevoje per beton e rrethoje estetike




Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 6- pike provizore pasiqe objekti ne ndertim e siper N:42.54033 E:20.288746
Nr i konteinerëve	1
Gjendja fizike e konteinerëve	Jo e mire
Gjendja fizike e lokacioneve	Jo e mire
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	Jo
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 6 Kontejner
Qasja për operim	Selia e Pdk rrethi në Deçan
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	Ska nevojë



Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 7 N:42.541714 E:20.289888
Nr i konteinerëve	Ska- Pike e re
Gjendja fizike e konteinerëve	/
Gjendja fizike e lokacioneve	Jo e mirë
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	/
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 5 Kontejner
Qasja për operim	Qasja prapa NLB banka-Rr.Hajdar Cacaj
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	Ska nevojë



Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 8 – provizore prej banoreve N:42.54475 E:20.290915
Nr i konteinerëve	/
Gjendja fizike e konteinerëve	/
Gjendja fizike e lokacioneve	Lokacion i vetekrijuar prej banoreve
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	/
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 3 Kontejner
Qasja për operim	/
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	Ska nevojë



Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 9 Rr. Luan Haradinaj 42°32'45.31"N 20°17'26.91"E
Nr i konteinerëve	3
Gjendja fizike e konteinerëve	Pjeserisht mire
Gjendja fizike e lokacioneve	E mire
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	/
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 3 kontejner
Qasja për operim	Nga rruga kryesore
Misurat/përmasat strukturale/nevoje per bazament/rrethoje	/



Nr i lokacioneve të konteinerëve	Pika 10. Rruga Deshmoret e Kombit N:42.53453 E: 20.292498
Nr i konteinerëve	2
Gjendja fizike e konteinerëve	Jo e mirë
Gjendja fizike e lokacioneve	Trotuar
A është i mjaftueshëm nr i konteinerëve	Jo
A ka hapësirë të mjaftueshme për konteinerë shtesë/1.1m ³ nëse po sa sasi mund të vendosen	Po 3 Kontejner
Qasja për operim	Perballë Restorant Banana Split

Anex 2

Disajni strukturor i PGM

Duke u bazuar në propozimet teknike numri total i pikave të grumbullimit që parashihet të intervenohen dhe mbulohen është 4 pika të grumbullimit të mbeturinave, të cilat parashihen të rrethohen dhe mbulohen (të specifikuara më lart) ndër të cilat planifikohet që komuna të bashkëfinancojë në ndërtimin e bazamenteve të betonit në 7 lokacione dhe Giz-SMS në ndërtimin e konstruksionit të rrëthojave si dhe shenëzimin informues në 4 Lokacione të specifikuara si më poshtë.

Bazuar në analizën e paraparë të GIZ, planifikohet që të intervenohet fillimisht prej anës së GIZ-SMS project, respektivisht në ndërtimin e konstruksionit të PGM 1 ; PGM 5 ; PGM 7; PGM 10, PGM 11.

Këto pika respektivisht bartin këto karakteristika:



Nr pikes PGM	Vendndodhja	Numri i kontenierëve të propozuar	Lloji i kontenierit	Karakteristika lokacioni
1	Sipas hartës së mësipërme	4 Konteniere	Metal	<i>Bazament betoni + rrethoje</i>
2		3		<i>Bazament betoni</i>
3		3		<i>Bazament betoni</i>
4		2		
5		4		<i>Bazament betoni + rrethoje</i>
6		6		
7		5		<i>Bazament betoni + rrethoje</i>
8		3		
9		3		
10		3		<i>Bazament betoni</i>
11	Kompleksi memorial	3		<i>Bazament + rrethoje</i>




Tab 13 #Sasia totale e kontenierëve dhe shpërndarja e pikave të grumbullimit për mbledhjen e ndarë të mbeturinave në zonën pilot.

Specifikat teknike të konstruksionit metalik



#Struktura e celikut





#Dimensionimi sipas përbërjes në sasi kontenierë (lokacion me 3 kontenierë)